



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M
Nr. 253, datë 03.12.2012

**“ Për
hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe
tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|-------------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Rezana | KONOMI | Zv. Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2012, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos.

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe ai 43, (pika 1) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Raportit të hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm ,

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, mori Vendimin Nr. 233, datë 16.07.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/Importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të Urdhrit Nr. 96, datë 19.07.2012 “Për ngritjen e grupit të punës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen e procedurave të këtij hetimi.
3. Në zbatim të këtij vendimi inspektorët e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës kanë kryer inspektime dhe kanë administruar informacionin nga ndërmarrjet që veprojnë në këtë treg.

II. TREGU PËRKATËS

4. Përcaktimi i tregut përkatës është realizuar në bazë të Udhëzimit nr.76 dt 07/06/2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, bazuar në dy dimensione:
 - a) *Tregu përkatës i produktit*
 - b) *Tregu përkatës gjeografik*

II.1 Tregu përkatës i produktit

5. Tregu përkatës i produktit është çimento gri me bazë 42.5 R rifuxho dhe e paketuar pasi ka një zëvendësueshmëri të ulët me kategoritë e tjera të çimentos për shkak të çmimit dhe të karakteristikave që ai mbart. Ky produkt nuk mund të zëvendësohet me një produkt tjetër që ofrojnë ndërmarrjet e prodhimit dhe të shitjes së çimentos, për shkak të karakteristikave specifike që mbart dhe që kërkojnë gjatë ndërtimit të strukturave të ndryshme inxhinjerike.

II.2 Tregu përkatës gjeografik

6. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm. Tregu gjeografik përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. KUFIZIMI I MUNDSHËM I KONKURRENCËS

7. Tregu i prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të produktit përkatës paraqet strukturën e një tregu me shkallë të lartë përqendrimi. Në këtë treg operojnë 3 ndërmarrje që prodhojnë në vend ndërsa dy prej tyre janë ndërmarrje importuese. Për periudhën objekt hetimi Janar – Gusht 2012, ndarja e tregut është si vijon:
 - “Fushë Kruja Cement” zë rreth XXX%,
 - Antea Cement zë një pjesë rreth XXX% të tregut të brendshëm,
 - Elbasan Cement zë pjesën prej XXX % të tregut,
 - Eurotech zë rreth XXX% të tregut
 - Colacem Albania zë pjesën prej XXX% të tregut.

8. Nga analiza e informacioneve të siguruara gjatë hetimit paraprak si dhe e faturave, konstatohet se të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari, si në tregun e prodhimit ashtu edhe të importit të produktit çimento 42.5 (Rifuxho dhe të paketuar), duke filluar nga data 22 shkurt 2012 (Ndërmarrjet prodhuese) deri në datën 2 Mars 2012 (Ndërmarrjet importuese), kanë rritur në mënyrë të njëkohshme dhe në një masë të konsiderueshme çmimin e tregtimit me shumicë të këtij produktit.
9. Këto shenja në kuptim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjnë një kufizim, pengim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun përkatës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg dhe konkretisht: “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK, “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK, “EUROTECH CEMENT” SHPK dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1.01. 2011 deri në 31.12.2012.
- III. Procedurat e hetimit të thelluar dhe përgatitja e raportit të përfundojnë jo më vonë se data 29.03.2013
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)
Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R